



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 24, datë 24.01.2024

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 426, DATË 14.10.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTAVE TIP ME AFATET E RUAJTJES SË DOKUMENTEVE GJYQËSORE QË ARKIVOHEN NË GJYKATA”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 1, shkronja “d”, nenin 90, pika 1, shkronja “gj” dhe neni 97, pika 1, shkronja “c” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 36 dhe nenin 48, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 7 të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

Në Vendimin nr. 426, datë 14.10.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e Listave tip dhe afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në aneksin 2, Dosjet e çështjeve gjyqësore penale, seria 2-005, “Çështjet penale në të cilat është dhënë pafajësia”: bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a. Seria 2-005, “Çështjet penale në të cilat është dhënë pafajësia”, afati ruajtjes 10 vjet, zëvendësohet me:

Seria 2-005, “Çështjet penale në të cilat është dhënë pafajësia”:

- për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm, afati i ruajtjes 40 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë, afati i ruajtjes 20 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, afati i ruajtjes 10 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i ruajtjes 5 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në dy vjet burgim, afati i ruajtjes 3 vjet;

- për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë, afati i ruajtjes 2 vjet.
2. Në aneksin 2, Dosjet e çështjeve gjyqësore penale, seria 2-005 “Çështjet penale në të cilat është vendosur pushimi i çështjes”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:
- a. Seria 2-005, Çështjet penale në të cilat është vendosur pushimi i çështjes, afati i ruajtjes 10 vjet, zëvendësohet me:

Seria 2-005, “Çështjet penale në të cilat është vendosur pushimi i çështjes”:

- për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm, afati i ruajtjes 40 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë, afati i ruajtjes 20 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, afati i ruajtjes 10 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i ruajtjes 5 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në dy vjet burgim, afati i ruajtjes 3 vjet;
- për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë, afati i ruajtjes 2 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR